

25 shtator 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 25.09.2026, Prishtinë

Plotësimi i Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore – edicioni 2026/27

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

1. Plotësohen Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore – edicioni 2026/27, përkatësisht dispozita që përcakton obligimin e ekipeve të Ligës së Parë të Meshkujve që në total të kenë 80 minuta në lojë lojtarët (2 lojtarë e më shumë) të lindur më të rinj se viti 2005, duke shtuar pasojat për mosrespektimin e këtij obligimi (neni 11.4.5).
2. Në rast të mosrespektimit të këtij kriteri për herë të parë, klubi dënohet me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro. Në rast të përsëritjes së mosrespektimit, klubi dënohet me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro, ndërsa trajneri i ekipit pezullohet për dy (2) ndeshjet e ardhshme.
3. Ngarkohet administrata e FBK-së që t'i njoftojë klubet përkatëse për këtë plotësim dhe t'ua përcjellë versionin e përditësuar të Propozicioneve të Garave.

Arsyetim


Duke marrë parasysh se Liga e Parë e Meshkujve për edicionin 2026/27 ende nuk ka filluar, Bordi vlerësoi të nevojshme që kriteri i përcaktuar në nenin 11.4.5 të Propozicioneve të Garave për aktivizimin e lojtarëve të rinj për gjithsej 80 minuta gjatë ndeshjes të plotësohet edhe me masat ndëshkuese në rast të mosrespektimit.

Me këtë plotësim, dispozita përkatëse bëhet e plotë dhe e qartë edhe sa i përket pasojave të mosrespektimit, duke përcaktuar masa më të qarta dhe më efektive në rast të përsëritjes së shkeljes. Kjo u mundëson klubeve që, para fillimit të garave, të jenë të informuara plotësisht për kriterin dhe pasojat e mosrespektimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

